



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

Drejtoria e Integritit dhe Projekteve

PROCEDURAT E REGJISTRIMIT NË CIKLIN E PARË
TË STUDIMEVE NË UNIVERSITETET FRANCEZE,
VITI AKADEMIK 2015-2016

Në kuadrin e Bashkëpunimit Kulturor, Ambasada e Republikës së Francës në Tiranë njofton se ka filluar fushata e para- regjistrimit 2015-2016 për kandidatët e huaj në ciklin e parë të studimeve (universitete dhe shkollë arkitekturë) në Francë. Materialet e aplikimit për pranimin paraprak mund të tërhiqen pranë zyrave të Shërbimit të Bashkëpunimit dhe Veprimt Kulturor të kësaj Ambassade, duke filluar nga data deri **16 dhjetor 2014**, çdo ditë, nga e hëna në të enjte, ora 14:00-17:30. Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dosjet e plotësuar në Ambasadë duke filluar nga data **17 dhjetor 2014** deri në **22 janar 2015** që është dhe afati i fundit për aplikim (nga e hëna deri të enjten, midis orës 14:30 dhe 16:30).

Procedura e aplikimit:

Mbas dorëzimit të dokumentacionit, aplikantët do t'i nënshtrohen një provimi, lidhur me njohjen e gjuhës frënge (TCF), i cili do të organizohet në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës në datën **11 shkurt 2015**, nga ora 9:00-13:00. Ky provim është i detyrueshëm për të gjithë aplikantët, me përjashtim të nxënësve të seksioneve dygjuhëshe dhe nxënësve që kanë nivelin DELF B2 dhe DALF C. Në momentin e dorëzimit të dosjes së regjistrimit, kandidati që do të kalojë testin TCF DAP duhet të paguajë 65 €.

Për më tepër informacion mbi procedurën e regjistrimit paraprak (e cila realizohet në gjuhën frënge), studentët shqiptarë duhet t'i referohen adresave online në vijim:

<http://www.enseignementsup-recherche.gouv.fr/pid24665-cid24144/-dossier-blanc-demande-prealable-a-une-inscription-en-premier-cycle.html>

<http://www.archi.fr/ECOLES/>

DREJTORIA E INTEGRIMIT DHE PROJEKTEVE